



Universiteti i Elbasanit  
**“ALEKSANDËR XHUVANI”**

**THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME**  
NË KUADËR TË PROJEKTEVE PËR KËRKIM  
DHE ZHVILLIM SHKENCOR PËR VITIN  
AKADEMIK **2026-2027**

*7 korrik 2026*



## THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME NË KUADËR TË PROJEKTEVE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM SHKENCOR PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

7 korrik 2026

Personeli akademik i UE-së, në mbështetje të Udhëzimit të Rektorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Nr. 2, datë 24.02.2026, ftohen të aplikojnë në Thirrjen për Projekt-Propozime të kërkimit dhe zhvillimit shkencor, me mbështetje financiare nga të ardhurat e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për vitin akademik 2026-2027.

### I. Fushat Prioritare

Fushat për të cilat hapet thirrja për projekt-propozime në kuadër të projekteve të kërkimit dhe zhvillimit shkencor për vitin akademik 2026–2027 përcaktohen në përputhje me fushat e studimit dhe kërkimit të fakulteteve të universitetit, si më poshtë:

- **Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë:** shkencat juridike si dhe shkencat ekonomike, ku përfshihen fusha, si: ekonomia, financa, kontabiliteti, administrimi i biznesit, marketingu etj.
- **Fakulteti i Shkencave të Edukimit:** shkenca sociale, shkencat e edukimit, mësimdhënie, edukimi fizik dhe sporte etj.
- **Fakulteti i Shkencave Humane:** shkencat humane, shkencat e komunikimit dhe medias, gjuhësia dhe letërsi etj.
- **Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike:** shkencat mjekësore teknike, shkencat e shëndetit, diagnostikimi dhe testimi laboratorik, si dhe disiplinat të tjera të lidhura me kujdesin shëndetësor etj.
- **Fakulteti i Shkencave të Natyrës:** biologjia, kimia, matematika, fizika, teknologjitë e informacionit, testimi laboratorik dhe shkencat mjedisore etj.

### II. Qëllimi i thirrjes

Qëllimi i thirrjes për Projekt-propozime është nxitja dhe mbështetja e realizimit të veprimtarisë së kërkimit dhe zhvillimit shkencor, përmes financimit me grante të projekteve të propozuara nga personeli akademik me kohë të plotë i UE-së, duke bërë pjesë të këtyre veprimtarive edhe studentë të UE-së.

### III. Cilët kanë të drejtë të aplikojnë

Në kuadër të projekt-propozimeve me mbështetje financiare nga të ardhurat e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", kanë të drejtë të aplikojnë për financim personeli akademik me kohë të plotë i UE-së.



#### **IV. Kohëzgjatja, buxheti dhe financimi**

1. Shtrirja kohore e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit shkencor të financuara nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” mund të jetë 1 - 36 muaj.
2. Financimi brenda vitit buxhetor për secilin vit duhet të përfundojë deri më 31 tetor (të gjitha faturat duhet të likujdohen brenda kësaj periudhe).

#### **V. Kriteria të përgjithshme për aplikim**

Për të qenë të pranueshëm për financim në kuadër të kësaj thirrjeje, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme të përgjithshme:

1. Aplikimi për projektin e propozuar si drejtues projekti, duhet të bëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i UE-së sipas përcaktimeve në pikën 3 të Udhëzimit të Rektorit, Nr. 2, datë 24.02.2026.
2. Projekt-propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor, duke përjashtuar aktivitete siç mund të jenë: trajnimet, përkthimet, ngritje e kapaciteteve institucionale, aktivitete promovuese, këshilluese/përfaqësuese (advokuese) apo monitoruese (kur këto përbëjnë aktivitetet kryesore të projektit dhe nuk janë pjesë e kërkimit shkencor).
3. Projektet e financuara nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” duhet t'u përmbahen parimeve të barazisë gjinore. Kriteret e vlerësimit do të përfshijnë ekuilibrin gjinor të ekipit, si dhe potencialin që kërkimi të promovojë barazinë gjinore.
4. Projekt-propozimet mund të aplikohen individualisht ose në grup kërkimor.
5. Çdo aplikues mund të jetë koordinator (drejtues) vetëm i një projekti në këtë thirrje.
6. Propozimi duhet të përmbajë objektiva të qarta, metodologji të mirëstrukturuar dhe plan pune të detajuar.
7. Duhet të paraqitet rëndësia shkencore dhe ndikimi i pritshëm akademik, ekonomik ose shoqëror.
8. Rezultatet e pritshme të Projekt-propozimeve duhet të jenë të matshme dhe përcaktuar sipas Udhëzimit të Rektorit të UE-së, Nr. 2, datë 24.02.2026, në pikën 2/a, b (publikime shkencore, libër abstraktesh, proceeding, monografi, prototipe, raporte, patenta, etj.).
9. Projekt-propozimet duhet të respektojnë standardet etike të kërkimit shkencor në përputhje me VKM nr. 831, datë 30.12.2025 “Për miratimin e kodit të etikës në shkencë dhe në kërkim shkencor”.
10. Projekt-propozimet duhet të respektojnë parimet e integritetit akademik dhe të autorësisë shkencore, duke siguruar që projekti i paraqitur të jetë origjinale dhe duke shmangur çdo formë plagjiature ose përdorimi të paautorizuar të materialeve të tjerëve.
11. Projekt-Propozimet do të vlerësohen nga një komision shkencor e profesional mbi bazën e meritës shkencore, realizueshmërisë dhe ndikimit.
12. Vetëm Projekt-propozimet që plotësojnë kriteret formale dhe shkencore do të kualifikohen për financim.



## **VI. Kategoritë e projekteve që do të kenë përparësi në financim:**

1. Projekt-propozimet e kërkimit e zhvillimit shkencor të cilat adresojnë prioritetet strategjike të UE-së, prioritetet kombëtare si dhe ato të Zonës Europiane të Kërkimit (European Research Area-ERA), të cilat mund të sillen edhe si punime në bashkëpunim me kërkues shkencorë brenda e jashtë vendit.
2. Projekt-propozimet e kërkimit shkencor që kanë lidhje drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen e konkurrueshmërisë, inovacionin teknologjik dhe transferimin e njohurive në treg.
3. Projekt-propozimet e kërkimit shkencor që vijnë si bashkëpunim i UE-së me IAL të tjera brenda ose jashtë vendit, me institucionet publike qendrore dhe vendore për zgjidhjen e problematikave në sektorë të ndryshëm socio-ekonomikë, si dhe ato që adresojnë grupet sociale në risk, me fokus të veçantë fëmijët dhe të rinjtë.
4. Projekt-Propozimet që mbështesin kërkimin shkencor në fushat e lartpërmendura duke përfshirë në këtë proces kërkuesit e rinj dhe studentët që ndjekin programmet e studimit të ciklit të tretë.
5. Projekt-propozime ndërdisiplinore dhe multidisiplinore që integrojnë ekspertiza nga fusha të ndryshme për të ofruar zgjidhje inovative dhe të qëndrueshme.
6. Projekt-propozime që parashikojnë bashkëpunim ndërkombëtar me universitete, institute kërkimore apo qendra ekselence, si dhe aplikime të përbashkëta në programe evropiane dhe ndërkombëtare.
7. Projekt-propozime që synojnë zhvillimin e produkteve, shërbimeve, prototipeve ose modeleve të aplikueshme në praktikë, me potencial për tregti, reklamë ose përfitim të pronësisë intelektuale.
8. Projekt-propozime që kontribuojnë në digjitalizim, transformim teknologjik, inteligjencë artificiale, siguri kibernetike dhe inovacion të bazuar në teknologji të avancuara.
9. Projekt-propozime që adresojnë çështje të qëndrueshmërisë mjedisore, ndryshimeve klimatike, energjive të rinovueshme dhe zhvillimit të gjelbër.
10. Projekte që përfshijnë partneritet me sektorin privat dhe që garantojnë bashkëfinancim ose mbështetje financiare/teknike nga palë të treta.
11. Projekt-propozime që parashikojnë publikime në revista shkencore të indeksuara ndërkombëtarisht dhe rrisin dukshmërinë akademike të institucionit.
12. Projekt-propozimet që implementojnë qasjen e inovacionit të hapur sipas modelit Quadruple Helix, duke integruar akademinë, industrinë, qeverisjen dhe shoqërinë civile në të gjitha fazat e projektit (konceptim, zbatim, transferim rezultatesh dhe komercializim), si dhe duke siguruar mekanizma të qartë bashkëpunimi dhe ndikimi të qëndrueshëm.



## **VII. Dorëzimi i aplikimeve**

1. Projekt-propozimi i kërkuar sipas Udhëzimit të Rektorit të UE-së, Nr. 2, datë 24.02.2026, së bashku me shkresën përcjellëse të Dekanit të Fakultetit përkatës ku buron thirrja, duhet dorëzuar në protokollin e Universitetin të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, pranë Rektoratit në 2 kopje të shtypura fizikisht dhe njëkohësisht në mënyrë elektronike në adresën e emailit [kerkimshkencor@uniel.edu.al](mailto:kerkimshkencor@uniel.edu.al).
2. Afati i fundit për depozitim të aplikimeve në protokollin e Universitetin të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, pranë Rektoratit është data 30/09/2026.

## **VIII. Informacione të tjera**

1. Aplikantët duhet t'i referohen Udhëzimit të Rektorit të UE-së, Nr. 2, datë 24.02.2026 për “Projekt-propozimet e kërkimit dhe zhvillimit shkencor me mbështetje financiare nga të ardhurat e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.
2. Projekt-propozimet që nuk i përmbahen Udhëzimit të Rektorit të UE-së, Nr. 2, datë 24.02.2026, kanë pasaktësi në plotësimin e formës së aplikimit apo që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në udhëzimin përkatës, do të skualifikohen në fazën e shqyrtimit administrativ dhe nuk do të kalojnë për vlerësim teknik.
3. Udhëzimin dhe formularin e aplikimit të projekt-propozimeve mund t'i gjeni në faqen zyrtare të universitetit: [www.uniel.edu.al](http://www.uniel.edu.al).
4. Kalendar i Thirrjes për aplikim të Projekt-Propozimeve:

| <b>Emërtimi i veprimtarive sipas fazave të Thirrjes për aplikim</b> | <b>Data</b> |
|---------------------------------------------------------------------|-------------|
| Publikim i thirrjes për aplikim të projekt-propozimeve              | 07.07.2026  |
| Dorëzimi i dokumentacionit të projekt-propozimeve                   | 30.09.2026  |

Njoftimi mbi përzgjedhjen dhe miratimin e financimit të projekt-propozimeve të kërkimit dhe zhvillimit shkencor me mbështetje financiare nga të ardhurat e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për vitin akademik 2026-2027 do t'u përcillet aplikantëve në formë elektronike, nëpërmjet adresës zyrtare të email-it: [kerkimshkencor@uniel.edu.al](mailto:kerkimshkencor@uniel.edu.al).